

**AKT THEMELIMI E STATUTI
I SHOQERISE "Darktrace" SH.P.K**

Ne mbështetje të Ligjit Nr.9901 dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" si dhe të gjithë Legjislacionit Shqiptar në fuqi;
Z. Marco Mancini i datelindjes 12/03/1980, banues në Roma, mbajtës i kartës së identitetit me nr. (ID) Nr. AX8769534 madhor dhe me zotesi të plote për të vepruar;

Sot me dt. 25.09.2019, hartuan këtë Statut të Shoqërisë "Darktrace" Sh.p.k.

**KAPITULLI
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Themelimi, Forma dhe Emertimi i Shoqërisë

- 1.1 Krijohet shoqëria "Darktrace" Sh.p.k.
- 1.2 Shoqëria është Person Juridik Privat dhe një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.
- 1.3 Akti i themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar që është i detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2

Themeluesit

- 2.1 Shoqëria është themeluar nga Z. Marco Mancini i cili është Ortak i shoqërisë.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

- 3.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me legjislacionin tregtar aktual shqiptar do të jetë:
 - a. Krijimin, programimin, menaxhimin e software të përgjithshëm dhe të specializuara
 - b. Krijimin, programin dhe menaxhimin e faqeve dhe website intranet
 - c. Shitjen, leasing, dhenien me qera, mirmbajtjen e software, hardware për zyra, makineri zyre e kompjuter, aksesoreve dhe materialeve për zyra si informative dhe jo
 - d. Idejimin, realizimin, ofertat e shërbimeve informatike tele-audio
 - e. Regjistrimin, tregtimin, dhenien dhe marrjen me qera, përdorimin e patentave dhe licensave informatike
 - f. Promovimin dhe menaxhimin e shërbimeve publicitare dhe të kërkimit/studimit të tregut
 - g. Zhvillimin e veprimtarive të telekomunikimit dhe ofrimin e shërbimeve për asistencë informatike dhe internet
 - h. Analiza e vulnerabilitetit dhe rrezikut të kërcënimeve të sulmeve të integritetit fizik (hardware) dhe logjike-funksionale (software) të sistemeve informatike dhe të dhënave të përbajtura në ose shkëmbyera në komunikim me një ose më shumë përdorues dhe projektim tekniko-organizativ dhe funksional për të siguruar integritetin e të dhënave, fizike dhe / ose qasje logjike për ta vetëm për përdoruesit e autorizuar, mbrojtjen e sistemeve informatike nga sulmet e jashtme dhe funksionalitetin e vete sistemeve.
 - i. Dhënie konsulentesh në fushën e sistemeve dhe proceseve informatike për përpunimin e të dhënave dhe informacioneve
 - j. Blerjen, projektimin, krijimin dhe shitjen e sistemeve dhe produkteve për përpunimin e proceseve të menaxhimit të biznesit
 - k. Ofrimin e shërbimeve të analizës dhe programimit të lidhura me botën e informatikës.
- 3.2 Shoqëria mund të ushtrojë, gjithashtu, kërkimin, zhvillimin dhe ofrimin e zgjidhjeve softëare inovative, globale dhe/ose të specializuara, në mbështetje të veprimtarive të menaxhimit të biznesit në fushat e:
 - a. Re-inxhinierisë së proceseve, inxhinierisë dhe inovacionit teknologjik;
 - b. Formimit dhe trajnimit të përdoruesve (corsëare) dhe projekte të tjera trajnimi;
 - c. Kërkimit, zhvillimit dhe ofrimin të sistemeve të monitorimit, me sisteme elektronike dhe/ose informative të intergruara, të aspekteve të riskut dhe mjedisit të proceseve industriale dhe shërbimeve



- d. Kërkimit, zhvillimit dhe ofrimit të sistemeve, pajisjeve dhe produkteve të programimit për përpunimin elektronik të proceseve dhe menaxhimin e biznesit si dhe dhënien e prezantimeve të analizave dhe programimit softëare
 - e. Realizimit, administrimit dhe monitorimit i rrjeteve të telekomunikimit dhe, në veçanti, të rrjeteve të transmetimit të të dhënave për shërbime globale dhe/ose lokale, nëpërmjet instalimit dhe/ose ushtrimit të çdo lloj teknike, mjete dhe sistemi të impianteve dhe pajisjeve të lëvizshme ose të palëvizshme, rrjete të dedikuara dhe/ose të integruara, për kryerjen dhe administrimin, pa kufizime territoriale, të shërbimeve të telekomunikimit me koncesion për përdorim publik ose në treg të lire.
 - f. Blerjes, përpunimit dhe ofrimit, për llogari të të tretëve, të të dhënave dhe informacioneve të çdo lloj natyre, publike apo biznesi, qoftë profesionale, industriale dhe tregtare;
 - g. Promovimin e specializimit të kompetencave individuale dhe të bashkëpunimit ndërsektorial, azhurnimit profesional dhe kulturor të personave të përfshirë në fushat e sipërpërmendura.
- 3.2 Për realizimin e këtyre objektivave, lista e të cilave është që të konsiderohen vetëm si shembuj dhe jo shteruese, kompania do të plotësojë të gjitha këto operacione industriale, tregtare, financiare, mobiliare dhe imobiliare mund të jenë të nevojshme ose të dobishme, duke përfshirë operacionet e kreditit, ndertimit dhe hipotekave, fraksionimi, shtyrje, zëvendësimi, kufizmit, shtyrjes, fshirjes hipotekore dhe çdo gjë tjetër që mund të kërkohet nga zyrat publike ose private ose rezultojnë e nevojshme ose të dobishme për shoqërinë; gjithmonë për arritjen e qëllimeve të shoqërisë mund të nxjerrë garanci dhe garanci reale, në institucionet e kreditit ose të palëve të treta; ajo mund të marrë, direkt ose indirekt, pjesëmarrje në shoqëri të tjera ose biznese që kanë objekt të ngjashme apo analoge, ose të lidhura me vetë.

Per te gjithë veprimtarite per te cilat do kerkohet autorizim, shoqeria do te pajiset paraprakisht me to ose te kryeje regjistrimet e nevojshme. Per zbatimin e te gjitha veprimtarive te permendura shoqeria do te punesojë profesioniste. Shoqeria mund te aplikojë per te gjitha lehtesirat dhe perfitimit te parashikuara nga legjislazoni ne fuqi dhe nga ai qe do te miratohet.

Te gjitha veprimtarite e pershkrura me siper mund te zhvillohen si ne Shqiperi ashtu edhe jashte vendit.

Neni 4

Selia e shoqërisë dhe degët

- 4.1 Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë në adresën: Rruga Frank Bardhi, Pallati 2, Kati 2, (Qendror Kristal) Tirana.
- 4.2 Transferimi i selisë së shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.
- 4.3 Shoqëria ka të drejtë të operojë me zyra, filiale, degë apo agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë apo dhe jashtë vendit.
- 4.4 Zyrat, filialet, degët apo agjensitë krijohen me Vendim të Ortakëve të Shoqërisë, të cilët organizojnë punën dhe emerojnë organet drejtuese dhe përfaqësuesit e tyre ligjor.

Neni 5

Kohezgjatja e shoqërisë

- 5.1 Kohezgjatja e shoqërisë "Darktrace" sh.p.k është e pakufizuar dhe fillon në momentin e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar.
- 5.2 Ky afat mund të ndryshohet në çdo kohë me vendim të ortakëve të shoqërisë.
- 5.3 Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të ortakëve të shoqërisë.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

- 6.1 Kapitali themeltar është 1.000.000 leke (një milion Leke) dhe është i ndarë si më poshtë ;
Z. Marco Mancini zoteron një kuotë me vlerë të përgjithshme 1.000.000 Leke, që përben 100 % të kapitalit themeltar .

Marco Mancini

Neni 7
Ndryshimi i kapitalit themeltar

- 7.1 Kapitali themeltar i shoqerise mund te shtohet apo te pakesohet vetem me vendim te Ortakut te Vetem.
- 7.2 Ne cdo rast kapitali nuk mund te zvogelohet nen kufijte e parashikuara nga ligji.

KAPITULLI III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

- 8.1 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
- 8.2 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
- 8.3 Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:
 - a. percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
 - b. ndryshimet e statutit;
 - c. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e. percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
 - f. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j. përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k. riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
 - l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m. ceshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e pergjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 8.5 Administratori i shoqerisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e pergjithshme.
- 8.6 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së pergjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

- 9.1 Asambleja e pergjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 9.2 Kur asambleja e pergjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

- 10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e pergjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 10.2 Në rastin kur asambleja e pergjithshme duhet të vendosë për ceshtje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.



- 10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

- 11.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 11.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
- përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë
- 11.3 Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12

Përfshirja nga e drejta e votës

- 12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- a. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d. ç) dhënie ose jo të përfitimeve të reja.
- 12.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

- 13.1 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 13.2 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 13.3 Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë Asamblesë së Përgjithshme.
- 13.4 Të dhënat e identifikimit të administratorit:
Z. Marco Mancini i datelindjes 12/03/1980, banues në Roma, mbajtës i kartës së identitetit me nr. (ID) Nr. AX8769534.

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

- 14.1 Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
- a. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d. përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

Marco Mancini

- e. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g. raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 14.2 Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
- 14.3 sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- 14.4 shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 14.5 shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 14.6 Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 14.7 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

- 15.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 15.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale
- 15.3 ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 15.4 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administrator detyrohet:
- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- 15.5 ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- 15.6 d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 15.7 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 15.8 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 15.9 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- 15.10 ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- 15.11 d) jep kredi.

Mario Mancini

- 15.1 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit
- 15.2 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KAPITULLI IV

Viti financiar-ekspertet – shperndarja e fiimeve

Neni 16

Viti Financiar

- 16.1 Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti I pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

- 17.1 Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- 17.2 Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Neni 18

Fitimi qe shperndahet

Koha, menyra dhe shuma e fitimit qe shperndahen vendoset rast pas rasti nga Ortaket e shoqerise sipas raportit te administrimit ne perputhje me kete Statut, ligjin tregtar dhe gjendjen financiare te shoqerise.

KAPITULLI VI

PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 19

Shnderrimi i shoqerise

Shnderrimi i Shoqerise "Darktrace" sh.p.k ne shoqeri te tjera, kolektive ose me drejtim te thjeshte, mund te behet me vendim te Ortakeve te saj.

Neni 20

Shperberja e shoqerise

- 20.1 Shperberja e shoqerise, mund te ndodh ne çdo kohe dhe per një nga shkaqet që vijojnë:
Humbja e kapitalit te shoqerise;
a Pamundesi veprimi;
b Me vendim te Ortakeve te shoqerise.
- 20.2 Ne keto raste, Ortaket e shoqerise vendosin mbi menyren e likuidimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore duke iu percaktuar dhe kompetencat.
- 20.3 Administratori dhe likuidatori jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise se shoqerise per derisa ajo t'u dorezohet personave perkates fizik e juridik, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet ndaj personave te trete qe ka shoqeria. Ne rast se fondet disponibel, rezultojne te pamjaftueshme, per shlyerjen e detyrimeve te shoqerise, likuidatori mund t'i kerkoje ortakeve te shoqerise qe te kontribuojne me te gjithë kuotat e tyre per te pambushur detyrimet me te tretet.

Neni 21

Likuidimi i shoqerise

- 21.1 Menjehere pas marrjes se vendimit per prishjen e shoqerise, Ortaket caktojne nje likuidator, kompetencat e tij dhe menyren e likuidimit te shoqerise , ne perputhje me dispozitat perkatese te ligjit tregtar.
- 21.2 Likuidatori i emeruar nga ortaket menjehere sapo merr detyren eshte i detyruar te publikoje bilancin e shoqerise duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe ta vendose ate ne dispozicion te Ortakeve

Marco Mancini

21.3 Me caktimin e likuidatorit pezullohen te gjitha kompetencat e Administratorit/ve dhe ato i kalojne likuidatorit.

KAPITULLI VII
DISPOZITA KALIMTARE
Neni 22

Dispozita te fundit

- 22.1 Per te gjitha ceshtjet qe nuk gjejne rregullim ne kete Statut, aplikohen dispozitat e Ligjit Nr.9901 date 14.04,2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” si dhe plotesimet qe do te behen nga Ortaket. Ndryshimet e plotesimet e ketij Statuti behen ne menyren dhe proceduren me te cilen nxirret vete statuti.
- 22.2 Per efekt te interpretimit te ketij Statuti me ligj tregtar nenkuptohet ligji Nr.9901 date 14.04.2008 “Per shoqerite tregtare”.
- 22.3 Pavlefshmerite eventuale te dispozitave te vecanta te Statutit nuk mund te cenojne vlefshmerine e tij.

Neni 23
Gjykata Kompetente

Gjykata kompetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarreveshjeve midis ortakeve dhe interpretimin e Statutit te Shoqerise eshte Gjykata e Rrethit Gjyqsor, Tirane.

ORTAKET
E SHOQERISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

***“Darktrace SH.P.K”**

Marco Mancini